VENDIM
Nr. 134, datë 7.3.2018

PËR KRIJIMIN E BAZËS SË TË DHËNAVE SHTETËRORE PËR SISTEMIN E INTEGRUAR BIBLIOTEKAR DATABKSH

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, "Për bazat e të dhënave shtetërore", me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e bazës së të dhënave shtetërore për Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë. Baza e të dhënave të Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë quhet dataBKSH.

2. Institucioni administrues i dataBKSH-së është Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë.

3. Të dhënat parësore të dataBKSH-së janë si më poshtë vijon:

a) Përshkrimi bibliografik;

b) Klasifikimi dhjetor;

c) Fjalët kyçe;

ç) Numri i vendit;

d) Numri i inventarit;

dh) ISBN-ja (për librin).

4. Dhënës të informacionit sa i përket dataBKSH-së janë botuesit/entet botuese, institutet, qendrat, fondacionet, institucionet, sistemi ndërkombëtar bibliotekar, sistemi universitar dhe akademik.

5. DataBKSH shkëmben informacione me institucionet publike dhe private, që ushtrojnë funksione publike, sipas ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, "Për bazat e të dhënave shtetërore", lidhur me statusin e standardeve shqiptare dhe fushat që lidhen me to. Në sistemin ndërkombëtar të informacionit, ajo ndërvepron edhe me databazat e bibliotekave të sistemit ndërkombëtar bibliotekar, të organizatave ndërkombëtare në fushën e shkencës së bibliotekave dhe të informacionit, të librit, të trashëgimisë kulturore, të portaleve evropiane e botërore, duke u bazuar në të drejtat dhe detyrimet e statusit të anëtarësimit të BKSH-së në këto organizata dhe/ose rrjete rajonale, evropiane e botërore.

6. Të gjitha subjektet e interesuara kanë qasje të lirë në leximin dhe printimin e të dhënave të detajuara rreth materialit bibliotekar që kërkojnë (libra, artikuj, materiale dëgjimore-pamore, periodikë, harta dhe disertacione), si dhe kanë mundësi të krijojnë, të ruajnë e të printojnë lista bibliografike sipas tematikave të caktuara.

7. Përdoruesit e dataBKSH-së janë:

a) Lexuesit;

b) Bibliotekarët;

c) Bibliografët;

ç) Klasifikatorët.

Funksionet dhe të drejtat e secilit përdorues janë në përputhje me pozicionin e punës, të përcaktuara në procedurat e punës së këtij institucioni dhe të miratuara në rregulloren e brendshme të BKSH-së nga drejtori për secilin nga punonjësit e saj.

8. Subjektet e interesuara për dataBKSH-në janë si më poshtë vijon:

a) Qytetarët;

b) Institucionet;

c) Qendrat;

ç) Organizatat;

d) Shoqatat;

dh) Fondacionet;

e) Sistemi kombëtar dhe ndërkombëtar bibliotekar;

ë) Sistemi universitar kombëtar;

f) Sistemi akademik kombëtar.

9. Të gjitha ndryshimet në arkitekturën *software* dhe *hardware* të dataADLIB-së të Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë, të cilat mund të ndodhin në varësi të nevojave të institucionit dhe të praktikave evropiane e ndërkombëtare në fushën e shkencës së bibliotekave dhe të informacionit, të bëhen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

10. Ngarkohet Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama